



<b>Temat e Takimit:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Sqarim i sinqertë i gjendjes aktuale sa i përket ndërtimit, në çdo aspekt</li><li>2. Diskutim mbi mundësinë e angazhimit të një arkitekti profesionist dhe përgjegjësitë ligjore që ai do të mbajë</li><li>3. Raport mbi bilancin e të hyrave dhe daljeve financiare dhe krahasimi me informacionin e publikuar në faqen zyrtare</li><li>4. Informacion mbi fushatat e reja të donacioneve dhe hapat konkretë që duhen ndërmarrë</li><li>5. Nevoja për të ruajtur harmoninë mes nesh si komisione me të njëjtin qëllim, si dhe angazhimi maksimal në këtë drejtim</li></ol>
<b>Data:</b>	<b>17.08.2025</b>
<b>Ora:</b>	<b>17:00 – 18:30</b>
<b>Vendndodhja:</b>	<b>Takimi u zhvillua online përmes WhatsApp-it</b>
<b>Pjesëmarrësit:</b>	<b>Don Ambroz Demaj, Sokol Syla, Marjan Gojani, Dedë Gojani, Nikollë Nikprelaj, Riqard Gjonaj, Kolë Berisha</b>  Ky takim nuk ishte i parashikuar për të gjithë fshatin, por vetëm për stafin organizativ (Don Ambroz Demaj, Marjan Gojani, Kolë Berisha), si dhe për ekipin e ndërtimit dhe financave (Sokol Syla, Dedë Gojani, Nikollë Nikprelaj, Riqard Gjonaj). Takimi u mbajt si vazhdim i mbledhjes urgjente të datës 14.08.2025, e thirrur nga Kolë Berisha, në të cilën kishin marrë pjesë vetëm Sokol Syla, Marjan Gojani, Kolë Berisha dhe sporadikisht Nikollë Nikprelaj.  Kolë Berisha e thirri këtë mbledhje urgjente, pasi, sipas tij dhe informacioneve që ai kishte në dispozicion, niveli i transparencës dhe cilësia e punimeve të fundit nuk përputheshin me informacionet e dhëna gjatë takimit online të datës 10.08.2025, por as me gjendjen reale në terren.
<b>Kryesuesi:</b>	<b>Stafi Organizativ</b>
<b>Dokumentator:</b>	<b>Kolë Berisha</b>

1

## Përmbledhje e Takimit Online

Takimi u hap nga Kolë Berisha, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre në numër të plotë. Më pas, ai prezantoi shkurtimisht pikat e rendit të ditës dhe ia kaloi fjalën Don Ambrozit, i cili kërkoi që të mos ndërpritej derisa ta përfundonte fjalimin e tij.

## Në vijim pasqyrohen në detaje pikat e trajtuara gjatë takimit

### **1. Sqarim i sinqertë i gjendjes aktuale sa i përket ndërtimit, në çdo aspekt:**

Takimi filloi me një reagim emocional nga Don Ambroz Demaj, i cili, me një nervozizëm të dukshëm, e pyeti kryesuesin e mbledhjes, Kolë Berisha, për arsyet e thirrjes së mbledhjes urgjente të datës 14.08.2025. Ai theksoi se vetëm pak ditë më parë, më 10.08.2025, ishte mbajtur një takim tjetër, dhe se atë ditë kishte pasur gjithashtu edhe komunikim telefonik mes tyre.



Don Ambrozi vijoi me një sqarim të hollësishëm lidhur me ecurinë e deritanishme të punimeve ndërtimore, duke theksuar se ato janë realizuar me përpikëri dhe cilësi të lartë. Ai përmendi në veçanti ndërtimin e themelit të objektit (pllakës), betonimin, vendosjen e shtyllave dhe ndërtimin e mureve. Gjithashtu, ai pranoi – ashtu siç kishte theksuar edhe në mbledhjen e datës 10.08.2025 – se muri ka disa mangësi në aspektin estetik, por theksoi se këto nuk ndikojnë në stabilitetin dhe sigurinë strukturore të objektit. Ai nënvizoi se që në fillim të projektit kishte qenë i vetëdijshëm se do të përballej me sfida dhe zëra të ndryshëm, por aktualisht ndjehet i lodhur si fizikisht ashtu edhe emocionalisht nga këto situata të panevojshme. Sipas tij, nëse vazhdohet me një klimë të tillë mosbesimi dhe presioni, ai nuk do të jetë në gjendje ta çojë më tej këtë angazhim.

Më pas, fjalën e mori Kolë Berisha, i cili iu përgjigj Don Ambrozit duke theksuar se mbledhja urgjente ishte thirrur vetëm pasi ai ishte bindur se, pavarësisht përkushtimit dhe angazhimit të palodhur të të pranishmëve, niveli i transparencës së kërkuar – si me goj, ashtu edhe me shkrim – nuk ishte në nivelin e duhur. Ai theksoi se, deri më tani, nuk janë dhënë informacione të qarta dhe zyrtare lidhur me kompanitë që kanë kryer punimet, edhe pse një gjë e tillë është kërkuar disa herë.

Ai shtoi se, sipas vlerësimeve të disa donatorëve që kishin vizituar vendin gjatë pushimeve, punimet e fundit – në veçanti shtyllat dhe muri – nuk janë realizuar me cilësinë e parashikuar.

Kolë Berisha përmendi gjithashtu se, pasi kishte kontaktuar kompaninë që ishte përmendur si realizuese e punimeve, pronari i saj e kishte informuar se kompania nuk ka kryer asnjë punim deri më tani në këtë kishë. Ai shtoi se kjo firmë pritet të fillojë punimet gjatë kësaj vjeshte. Ky informacion i papritur e shtyu atë që të thërrasë menjëherë një mbledhje urgjente me qëllim sqarimin e situatës.

Fjalën më pas e mori Nikollë Nikprelaj, i cili në mënyrë profesionale sqaroi shumë nga zhvillimet teknike të ndërtimit deri më tani. Ai theksoi se cilësia e statikës është mbi standardet e zakonshme në Kosovë. Gjithashtu, pranoi se gjatë ndërtimit të murit kanë pasur disa mangësi estetike, por këto nuk e komprometojnë strukturën dhe sigurinë e objektit. Sipas tij, vendimet për bashkëpunim me kompani të ndryshme janë marrë me qëllim që punimet të realizohen me kosto më të ulët dhe të përballueshme për buxhetin e projektit.

Edhe Dedë Gojani dhe Riqard Gjonaj, në fjalimet e tyre, i mbështetën qëndrimet e Don Ambroz Demajt dhe Nikollë Nikprelajt, duke theksuar se puna deri më tani është kryer me kujdes të lartë dhe se parregullsitë e vogla të përmendura nuk e dëmtojnë sigurinë dhe procesin e mëtejshëm të ndërtimit.

Kolë Berisha mori fjalën përsëri dhe tha se puna që keni bërë në përgjithësi është për t'u lavdëruar, por që nga fillimi është thënë qartë, si me gojë ashtu edhe me shkrim, se nuk duhet kursyer në cilësinë e punës. Ai tha se çdo material dhe çdo punë duhet të jetë me cilësinë më të mirë që mund të gjendet në Kosovë. Ai theksoi se kjo është kisha e parë në botë e dedikuar Shën Nënë Terezës dhe do të jetë një vend që do ta vizitojnë jo vetëm besimtarët e këtij rrethi, por edhe shumë vizitorë nga vende të ndryshme. Gjithashtu, donatorët duhet të ndihen mirë që paratë e tyre janë përdorur për një punë të mirë dhe të jenë krenarë për kontributin e tyre. Me këto fjalë, dukej se të gjithë të pranishmit ishin dakord dhe me mendim të njëjtë.



Sokol Syla, në fjalën e tij, falenderoi të gjithë për kontributin e tyre, si dhe donatorët. Ai gjithashtu theksoi se për arsye shëndetësore mendon të tërhiqet nga detyra e besuar. Por në këtë moment reagoi Don Ambroz Demaj, i cili tha se kontributi i tij është shumë i çmuar dhe se ai duhet të jetë së paku anëtar i stafit të ndërtimit deri sa të përfundojnë punimet e vrazhda (deri sa të vihet pika jashtë).

Për këtë mendim u dakorduan të gjithë të pranishmit, të cilët edhe njëherë theksuan rëndësinë e pranisë së Sokolit në këtë staf, pasi ai ka një autoritet shumë të lartë në Dugajevë dhe në gjithë rrethin përreth. Prania e tij në staf jep siguri dhe kontribut të rëndësishëm në të gjitha aspektet.

Marjan Gojani, në fjalën e tij, gjithashtu i përgëzoi të gjithë aktivistët për punën e tyre të palodhshme dhe donatorët për bujarinë e tyre. Ai vlerësoi se po bëhet një punë e mirë dhe duhet të vazhdohet të punohet me kujdes dhe cilësi të lartë. Gjithashtu, theksoi rëndësinë e harmonisë mes gjithë aktivistëve dhe mes gjithë fshatit.

## **2. Diskutim mbi mundësinë e angazhimit të një arkitekti profesionist dhe përgjegjësitë ligjore që ai do të mbajë**

Sa i përket kësaj pike, u sqarua nga Don Ambroz Demaj, Nikollë Nikprelaj dhe anëtarët e tjerë të stafit të ndërtimit se që nga fillimi i punimeve është angazhuar një arkitekt profesionist, i quajtur Margon Matiqi nga Dërsniku i Klinës, i cili ka inspektuar të gjitha punimet deri më tani. Në këtë pikë reagoi edhe njëherë Kolë Berisha dhe theksoi rëndësinë e transparencës së plotë, duke thënë se nëse do të kishim pasur të gjitha këto informacione më herët, do të ishin kursyer shumë fjalë të panevojshme.

## **3. Raport mbi bilancin e të hyrave dhe daljeve financiare dhe krahasimi me informacionin e publikuar në faqen zyrtare**

Këtu e mori fjalën Don Ambroz Demaj, i cili prezantoi edhe një herë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar të të hyrave dhe shpenzimeve financiare.

Sipas tij, deri më sot janë mbledhur gjithsej 78.580,08 € nga donatorët. Nga këto mjete, janë shpenzuar 51.610,52 € për punimet që janë realizuar deri tani, duke përfshirë edhe pagesën për dritaret në shumë prej 5.500 €, e cila është bërë paraprakisht (si avans).

Ai informoi gjithashtu se në llogarinë bankare aktualisht ndodhen edhe 27.518,08 €, si dhe 6.500 dollarë amerikanë.

Të gjitha fondet janë transferuar dhe menaxhuar përmes llogarisë zyrtare bankare dhe janë përdorur vetëm për nevojat e ndërtimit të kishës.

Kolë Berisha theksoi se këto të dhëna nuk përputhen plotësisht me informacionin e publikuar aktualisht në faqen zyrtare të Kishës dhe se ka një dallim mes të dhënave të prezantuara dhe atyre online.

Pas kësaj, Don Ambroz Demaj u shpreh se mund të bëhet fjalë për ndonjë gabim teknik dhe kërkoi nga Kolë Berisha që ai t'i dërgojë një dokument me të dhënat e publikuara në faqe, në mënyrë që ato të krahasohen me llogaritë e tij, dhe nëse është bërë ndonjë gabim teknik, ai do të korrigjohet menjëherë.



Të njëjtin qëndrim shprehën edhe anëtarët e tjerë të stafit të ndërtimit dhe financave, të cilët u pajtuan që çdo mospërputhje eventuale të sqarohen me transparencë dhe saktësi.

## **Diskutim mbi cilësinë e drurit për konstruksionin e brendshëm të çatisë së kishës**

Gjatë diskutimit mbi përzgjedhjen e drurit për konstruksionin e brendshëm të çatisë së kishës, fjalën e mori Nikollë Nikprelaj. Ai theksoi se aktualisht nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të porositur dru me cilësinë më të lartë. Sipas tij, janë paraqitur dy mundësi:

- Të përdoret dru me cilësi të lartë, i cili është më i kushtueshëm,
- Ose të zgjidhet një variant standard, që gjithashtu është cilësor dhe i qëndrueshëm, por me çmim dukshëm më të ulët.

Nikollë Nikprelaj u shpreh se, për shkak të buxhetit të kufizuar, ai është i mendimit që të shkohet me variantin standard. Të njëjtin mendim ndanë edhe Don Ambroz Demaj, Marjan Gojani, Dedë Gojani dhe Riqard Gjonaj.

Nga ana tjetër, Kolë Berisha theksoi se është i mendimit që druri duhet të jetë i cilësisë më të lartë, edhe nëse kjo sjell kosto më të larta. Sipas tij, kemi të bëjmë me një kishë që duhet të jetë jetëgjatë dhe cilësore, pasi ndërtohet vetëm një herë dhe duhet të qëndrojë për breza. Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e cilësisë së drurit për pamjen dhe dinjitetin e brendshëm të kishës, duke shtuar se duhet bërë çdo përpjekje që të zgjidhet materiali më i mirë i mundshëm.

Pas këtij diskutimi dhe kundërshtimeve nga disa anëtarë të stafit për shkak të mungesës së fondeve, u ra dakord që të kërkohen dhe të paraqiten dy oferta konkrete: një për drurin me cilësi të lartë dhe një për drurin standard. Pas krahasimit të çmimeve dhe mundësive buxhetore, do të merret vendimi përfundimtar.

Kolë Berisha u pajtua me këtë propozim dhe theksoi: "Unë gjithmonë jam në pajtim me vendimin e shumicës, edhe pse nganjëherë ai mund të jetë i gabuar."

## **4. Informacion mbi fushatat e reja të donacioneve dhe hapat konkretë që duhen ndërmarrë**

Kolë Berisha tha shkurt se kemi një mundësi të re nga ACN International, një organizatë katolike që mbështetet nga Selia e Shenjtë. Ai e pyeti Don Ambrozin për hapat që janë marrë deri tani në këtë drejtim.

Don Ambrozi u përgjigj se ka kontaktuar ipeshkvin Dodë Gjergjin dhe do të takohet me të së shpejti. Ai siguroi gjithashtu se do t'i dërgojnë ACN International dhe organizatës Missio pro Europa të gjitha dokumentet e kërkuara, dhe se kjo do të bëhet në ditët në vijim.

Kolë Berisha bëri edhe një herë thirrje që dokumentet e kërkuara nga këto organizata kishtarë me karakter ndërkombëtar të dërgohen sa më shpejt, pasi vonesat mund të na kushtojnë shumë dhe mund të humbasim mundësi të rëndësishme për donacione.



## **5. Nevoja për të ruajtur harmoninë mes nesh si komisione me të njëjtin qëllim, si dhe angazhimi maksimal në këtë drejtim**

Marjan Gojani mori fjalën dhe theksoi rëndësinë shumë të madhe të kësaj pike, duke e quajtur jetike dhe shumë të nevojshme për suksesin e projektit.

Pas tij foli Kolë Berisha, i cili përfundoi këtë pikë me këto fjalë:

“Në aktivitetet e ekipeve të punës në përgjithësi, si edhe famullitari ynë Don Ambroz Demaj dhe i gjithë fshati mbarë, kanë shumë detyra, por dy prej tyre janë më të rëndësishmet:

Së pari, të punojmë dhe veprojmë në atë mënyrë që, kur të përfundojë projekti, të jemi të gjithë në gjendje shpirtërore që të përshëndesim dhe përqafojmë njëri-tjetrin me gëzim për punën e arritur, dhe të tregojmë kulturën, ashtu si na ka mësuar Shën Nënë Tereza.

Së dyti, çdo donator, kur hyn në kishë, të jetë i bindur se donacioni i tij nuk ka shkuar dëm, por që ai duhet të ndihet krenar për veprën e tij humanitare.”

### **Konkluzione të marra nga takimi:**

- Stafi i ndërtimit, i financave dhe i organizimit duhet të vazhdojë punën me intensitet të duhur, sinqeritet dhe transparencë të plotë. Nuk duhet të merret me thashetheme që mund të lindin, pasi ato pengojnë punën e tyre. Në rast se ka ankesa serioze, këto dy ekipe duhet të mbajnë takim dhe të diskutojnë për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundshme.
- Stafi i ndërtimit dhe i financave do të paraqesë dy ofertat për materialin e drurit, i cili do të përdoret për konstruksionin e brendshëm të çatisë së kishës. Më pas, duke marrë parasysh çmimin, fuqinë buxhetore dhe rëndësinë e këtij materiali, do të vendoset me shumicë votash se cila ofertë do të pranohet.
- Të punojmë të gjithë bashkë për të ruajtur harmoninë mes nesh, donatorëve dhe gjithë fshatit, sepse kjo është shumë e rëndësishme për suksesin e projektit tonë

5

---

**PS:** Kjo është përmbledhja e saktë e të dhënave, e dërguar nga Don Amroz Demaj më datën 19.08.2025:

- **Të ardhurat totale:** 85.525 € (përfshirë konvertimin e frangave dhe dollarëve sipas kursit të datës 09.06.2025: 1 \$ = 0,8710 €, 1 CHF = 0,105 €)
- **Shpenzimet totale deri më 19.08.2025:** 51.209,92 €
- **Bilanci i mbetur:** 34.315,08 €
- **Gjendja në llogarinë bankare më 19.08.2025:** 29.358 € dhe 6.500 \$

Këto janë të dhënat e verifikuara dhe përputhen me informacionin në **faqen zyrtare të internetit**.